



Pranuar / Dorezuar Priljenen / Prodato Received / Delivery	17-12-2021	viti / god Year	2021
Organ / Njesia Organ / Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPSHTK	6217/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.906/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, si dhe Sabile Avdyli -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.906/2021 të datës 04.11.2021 të parashtruar nga ankuesi ne adresë banimi rr “Bill Clinton” , Blloku B hyr.3, nr.37, kundër vendimit të Zëvendësuesit të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, AKP, nr.DM 1193/2021 të datës 27.10.2021, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 17.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.906 /2021 e datës 04.11.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në vendin e punës “Kryesues i Njesisë për Negocim Direkt” në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me datën 26.11.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5641/2021 kundër vendimit të Zëvendësuesit të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, AKP, nr.DM 1193/2021 të datës 27.10.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 10.11.2021 ka dërguar

kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Më datë 17.11.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e trajtimit të kësaj ankesë, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 04.11.2021 me numër protokoll 5285/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; vendimi i Zëvendësuesit të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, AKP, nr.DM 1193/2021 të datës 27.10.2021, E-mail zyrtar i datës 28.10.2021, Vendimi me nr.ref.BD -112/22 të datës 30.01.2019 i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Ligji Nr.04/L-34 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit . Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Akt emërimi i datës 19.02.2019 për _____ në pozitën Kryesues i Njësisë për Negocim Direkt, përshkrim i detyrave të punës, Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës e datës 01.06.2017, Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit e datës 30.01.2019, Organogrami i Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 17.11.2021 me numër protokoll 5285/2021 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/58.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e palejuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke marr parasysh pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se me vendimin e Zëvendësuesit të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, AKP, nr.DM 1193/2021 të datës 27.10.2021 në Njësinë e Negocimit Direkt shuhet pozita “Zyrtar i lartë për Kadastër “ dhe krijohet pozita e re “Zyrtar kadastral”, po ashtu shuhen edhe dy pozitat: Zyrtar i lartë i njësisë së negocimit Direkt “ në Agjencinë Kosovare të Privatizimit është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar që me rastin e shuarjes së këtyre pozitave sipas vendimit të Zëvendësuesit të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), nr.DM 1193/2021 të datës 27.10.2021, ankuesit nuk i është shkelur asnjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës, dhe me qenë se nuk kemi ndonjë cenim direkt të marrëdhënies së punës së ankuesit , mbi këtë bazë mungon edhe interesi juridik i ankuesit për të kërkuar ndonjë të drejtë mbi këtë bazë andaj edhe ankesa është e palejuar dhe në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht nenin 24 paragrafin 3 i cili shprehimisht parasheh se:’ ***Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji.***, andaj mbi arsyet e potencuara më lartë kolegji konstaton mungesën e bazës ligjore të adresimit të ankesës në KPMSHC, andaj edhe nuk është lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve të paraqitura në përmbajtje të kësaj ankesë.



Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës referuar dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrat e Publikë të Potencuar më lartë si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr.906/2021, datë 17.12.2021

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet

- Ankuesit
- Zëvendësuesit të Drejtorit Menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

